

Бр. Nr. 04-900/19
26.09 2019 год. viti
ЛИПКОВО - LIKOVË

Në bazë të nenit 52 paragrafi (1) të Ligjit për nëpunësit administrativ („Gz. zyrtare e R.M.-së,, nr. 27/14, 199/14, 48/15, 154/15, 5/16, 142/16 dhe 11/2018), Sekretari i Komunës së Likovës sjelli:

V E N D I M

për zgjedhjen e kandidatëve sipas Shpalljes interne me nr. 01/2019

1. Për realizues të vendeve të punës:

- **Udhëheqës i sektorit për urbanizëm, punë komunale dhe zvitllim ekonomik lokal, me shifër UPR 0101 B02 000, niveli B2**, në Sektorin për urbanizëm, punë komunale dhe zvitllim ekonomik lokal në Komunën e Likovës, zgjedhet kandidati, **XHEZMI MUSLIJI** dhe

- **Udhëheqës i sektorit për përkrahje të Kryetarit, këshillit të komunës dhe menaxhimit me resurset njerëzore, UPR 0101 B02 000, niveli B2**, në sektorin për përkrahje të Kryetarit, këshillit të komunës dhe menaxhimit me resurset njerëzore të Komunës së Likovës, zgjedhet kandidati, **BASHKIM ADEMI**.

2. Të lartpërmendurit do të punësohen në vendet e punës nga paragrafi 1 i këtij Vendimi pas përfundimit të procedurës për zgjedhjen dhe plotëfuqishmërisë së Vendimit, për çka do të sillet aktvendim për avansim të nëpunësit administrativ.

3. Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e sjelljes.

A R S Y E T I M

Më dt. 16.09.2019 në web faqen zyrtare të Komunës së Likovës dhe web faqen zyrtare te Agjencionit për administratë është shpallur Shpallje interne me nr. 01/2019 për plotësimin e vendeve të punës: **Udhëheqës i sektorit për urbanizëm, punë komunale dhe zvitllim ekonomik lokal, me shifër UPR 0101 B02 000, niveli B2**, në Sektorin për urbanizëm, punë komunale dhe zvitllim ekonomik lokal dhe Udhëheqës i sektorit për përkrahje të Kryetarit, këshillit të komunës dhe menaxhimit me resurset njerëzore, **UPR 0101 B02 000, niveli B2**, në sektorin për përkrahje të Kryetarit, këshillit të komunës dhe menaxhimit me resurset njerëzore.

Komisioni për selektim gjatë avansimit të nëpunësit administrativ, i formuar me Aktvendim me nr. 04-900/9 të dt. 20.09.2019, pas kryerjes së selektimit administrativ dhe intervistës së kryer të kandidatëve nga ana e Sekretarit, përgatiti dhe dorëzoi deri te Sekretari i Komunës së Likovës Propozim-Vendim për zgjedhjen e kandidatëve: Xhezmi Musliji dhe Bashkim Ademi me nr. 04-900/13 të dt. 25.09.2019.

Në bazë të lartpërmendurës, Sekretari i Komunës së Likovës kreu zgjedhjen si në dispozitiv.

MJET JURIDIK: Kundër këtij Aktvendimi mundet që të jipet ankesë deri te Agjencioni për administratë në afat prej 8 ditëve nga dita e dhënies së Aktvendimit.

Dorëzuar:

- Seksionit për menaxhim me resurset njerëzore
- Arkivit
- Nëpunësit administrativ



Komuna e Likovës
Sekretar
Nexhadi Osmani